



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE ASETIVE

PROJEKT VENDIM

Nr 2 Datë 21.04 2026

Për miratimin në parim të dhënies në përdorim me anë të konkurimit të pasurisë nr 1/29, Zk 8598, objektin e quajtur "Tregu" Vau Dejës, me sipërfaqe prej 800 m2, nga kjo 663 m2 "Ndërtesë", dhe 137 m2 "Truall funksional", pronë e Bashkisë Vau Dejës.

Fusha e përdorimit të pronës: "Për veprimtari tregëtare".

Bazuar në nenin 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja "e/1" (ndryshuar), neni 55 pika 4, të ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligji nr 38/2019, ligji nr 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", ligji nr 8744 datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar, në VKM-në nr 1423, datë 10.10.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vau Dejës, të Qarkut të Shkodrës", në VKM-në nr 54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", ndryshuar, në Udhëzimin nr 13, datë 26.04.2018, "Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", në VKM nr 672, datë 02.09.2020, "Për disa ndryshime në VKM-në nr 54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, në VKM-në nr 701, datë 13.11.2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime më VKM-në nr 54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kriterëve.....", ndryshuar, propozojmë që në mbledhjen e radhës, Këshilli Bashkiak të:

VENDOSI :

1. Miratimin në parim: Dhënie në përdorim me anë të konkurimit, të objektit të quajtur "Tregu", me nr Pasurie 1/29, Zk nr 8598, me afat deri 20 vjet, me sipërfaqe të përgjithshme prej 800 m2, nga e cila 663 m2 "Ndërtesë", dhe 137 m2 "Truall funksional", ndodhur në qytetin Vau Dejës.
2. Fusha e përdorimit të pronës: "Për veprimtari tregëtare".
3. Efektet: Siguron të ardhura për Bashkinë që kthehen më pas në investime publike, zhvillon pronën dhe e vë në efikasitet atë, si dhe jep impakt pozitiv në komunitet duke hapur vende të reja pune.


4. Tarifa dysHEME e qirasë mujore dhe afati i dhënies me qira do jetë në përputhje me parashikimet e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, ‘Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore’ ndryshuar, me VKM-në nr 672, datë 02.09.2020, “Për disa ndryshime të VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, (sipërcituar)”, sipas Udhëzimit nr 13, datë 26.04.2018, “Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014.....”, si dhe sipas Udhëzimit nr 1, datë 10.09.2025, të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2025”.
5. Detaje më të hollësishme rreth afatit të dhënies me qira dhe llogaritjes së çmimit dysHEME të qirasë mujore, i gjeni në Relacionin bashkëlidhur këtij Projekt Vendimi.
6. Pas miratimit në Këshill Bashkiak, dhe shprehjes së ligjshmërisë nga ana e Prefektit të Qarkut Shkodër, do vazhdohet me shpalljen në Buletinin e Njoftimeve Publike për hapjen e procedurave të konkurimit publik me të gjithë elementët e saj përbërës, deri në shpalljen e ofertës më të suksesshme dhe lidhjen e kontratës së qirasë me subjektin fitues.

HARTUESIT E PROJEKT VENDIMIT

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE ASETIVE

Sp/Juriste

Silvana Ismajlaj




P/sek Aseteve

Ndoc Baqli



Drejtori

Marinela Deda



KRYETARI
Kristian SHKRELI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETARI

Aleksandra Gjoni





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE ASETIVE

RELACION

MBI

Dhënien në përdorim me kontratë qiraje të pasurisë nr 1/29, Zk 8598, "Tregu" Vau Dejës, me sipërfaqe prej 663 m2 ndërtesë, dhe 137 m2 truall funksional. "Për veprimtari tregëtare".

Bashkia Vau Dejës, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të tjera ka edhe administrimin e aseteve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, me qëllim ndër të tjera edhe dhënien në përdorim të tretëve, me objektiv primar për të siguruar të ardhura për Bashkinë, që më pas kthehen në investime publike.

Bazuar në ligjin nr 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, bashkia jep në përdorim me kontratë qiraje pasuritë e paluajtshme në pronësi të saj, duke zhvilluar procedurën përkatëse të konkurimit, dhe në transparencë të plotë, sipas legjislacionit në fuqi për dhënie në përdorim të pasurisë shtetërore.

Bazuar në VKM-në nr 54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", ndryshuar, në Udhëzimin nr 13, datë 26.04.2018, "Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014 (sipërcituar), si dhe VKM-së nr 672, datë 02.09.2020, "Për disa ndryshime në VKM-në nr 54, datë 05.02.2014", ndër të tjera pasuritë e llojit "Ndërtesë", u jepen në përdorim subjekteve të interesuar, me kontratë qiraje, duke ndjekur të gjitha procedurat e konkurimit publik të parashikuara në legjislacionin përkatës për dhënien në përdorim të pasurisë shtetërore, me të gjithë elementët e saj përbërës, me afate të përcaktuara sipas sipërfaqes që jepet me qira. Bazuar në VKM-në nr 54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", ndryshuar, afati i lidhjes së kontratës, për sipërfaqet nga 200-500 m2, është deri në 10 vjet, dhe për sipërfaqet mbi 500 m2 deri 20 vjet.

Objekt i këtij Projekt Vendimi është dhënia në përdorim e pasurisë nr 1/29, Zk nr 8598, objekti i quajtur "Tregu", ndodhur në qendër të qytetit Vau Dejës, me sipërfaqe të përgjithshme prej 800 m2, nga e cila 663 m2 ndërtesë dhe 137 m2 truall funksional, e cila referuar përcaktimeve të mësipërme mbi afatet, mund të jepet me qira me afat deri 20 vjet. Ky objekt është transferuar "në pronësi", të Bashkisë Vau Dejës, me VKM-në nr 1423, datë 10.10.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vau Dejës të Qarkut të Shkodrës", me funksion "zhvillim ekonomik", "Në pronësi". Kemi aplikuar pranë ASHK-së DV Shkodër, për regjistrimin dhe nxjerrjen e çertifikatës së pronësisë për këtë pasuri, procedura e së cilës është "në proces".

Sa i takon përlllogaritjes së tarifës dysheme të qirasë mujore, referuar VKM-së nr 672, datë 02.09.2020, "Për disa ndryshime në VKM-në nr 54, datë 05.02.2014", në pikën 1 parashikohet

ndryshimi i VKM nr 54, date 05.02.2014, citoj: Në kreun III "Tarifa dhe vlera dysheme për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë" bëhen këto ndryshime: a) shkronja "a" e pikës 1, ndryshohet si më poshtë vijon: "a) për ndërtesat, të cilat quhen të tilla sipas përcaktimeve në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, në fushën e planifikimit të territorit, tarifa dysheme e qirasë mujore për metër katror është 0.3% e vlerës mesatare të shitblerjes së banesave, e përcaktuar në udhëzimin përkatës të këshillit të ministrave, për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, në fuqi në momentin e dhënies me qira të pasurisë shtetërore.

Në Udhëzimin nr 1, datë 10.09.2025, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2025", përkatësisht në Tabelën nr 1, parashikohen koston mesatare të ndërtimit sipas qyteteve.

Në pikën 3 të këtij Udhëzimi, citoj: Për qytetet, për të cilat nuk janë nxjerrë vlerat e koston mesatare të ndërtimit, merren vlerat e koston së ndërtimit të qytetit më të afërt, sipas Tabelës nr 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

Në rastin konkret, në mungesë të përfshirjes së qytetit Vau Dejës në Tabelën nr 1, ne do të referohemi qytetit më të afërt, që është qyteti i Shkodrës.

Sipas Tabelës nr 1, qyteti i Shkodrës e ka koston mesatare të ndërtimit 56,726 lekë/m².

Për efekt të llogaritjes së tarifës dysheme të qirasë mujore do marrim shifren prej **56,726 lek/m².**

Referuar sipërfaqes objekt trajtimi, rezulton se kemi nje sipërfaqe ndërtese prej 663 m², dhe sipërfaqe trualli funksional prej 137 m², të cilat për efekt llogaritjeje do i marrim të ndara.

Bazuar në VKM-në nr 672, datë 02.09.2020 sipërcituar), tarifa dysheme e qirasë mujore për metër katror është 0.3 % e vlerës mesatare të shitblerjes së banesave, e përcaktuar në Udhëzimin përkatës të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB, në fuqi në momentin e dhënies me qira apo enfiteozë të pasurisë shtetërore".

Nga llogaritja e vlerave vërejmë se: meqenëse vlera mesatare për m² e parashikuar në udhëzim është 56.726, atëherë 0,3% e kësaj vlere është e barabartë me 170.178 lekë/m².

Për sipërfaqen e ndërtesës prej **663 m² x 170.178 lek/m², llogaritet vlera = 112 828.014 lekë.**

Bazuar në kreun III, pika 1, shkronja "b" të VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, për sipërfaqen funksionale, tarifa dysheme e qirasë mujore është 20% e tarifës dysheme mujore për ndërtesën.

Në rastin konkret, 20% e vleres dysheme mujore prej 170.178 lek/m² është = 34.036 lek/m².

Për sipërfaqen funksionale prej **137 m², llogaritet vlera: 137 x 34.036 = 4662.932 lekë.**

Nga mbledhja e vlerave dysheme të tarifës mujore të ndërtesës dhe të truallit, del shuma: 112 828.014 lekë + 4662.932 leke = 117 490.946 lekë.

Hartuesit e Relacionit

S. Ismajlaj



N. Baqli



M. Deda



KRYETARI

Kristian SHKRELI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETARI

Aleksandra Gjoni





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE ASETIVE
Sektori i Aseteve

Nr. 2185 Prot.

Vau Dejës me 26.03 2026

Lënda : Kërkesë (regjistrim pasurie).

ASHK DR VENDORE SHKODËR
Adresa: Rruga "Jordan Misja" TIRANË

Bazuar në ligjin nr 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligji nr 8743, datë 22.02.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", ligji nr 8744, datë 22.02.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore", VKM nr 1423, datë 10.10.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vau Dejës, të Qarkut të Shkodres", po ju dërgojmë dokumentacionin e plotë për regjistrimin dhe paisjen me çertifikatë pronësie për pasurinë nr 1/29, Zk nr 8598, e llojit Ndërtesë+Truall, ndodhur në qytetin Vau Dejës, Bashkia Vau Dejës.

Bashkëlidhur: 1. Aplikimi nr 6400, datë 18.03.2026, (e-Albania), bashkë me mandatin e pagesës.
2. VKM nr 1423, datë 10.10.2008, bashkë me fletën e inventarit përkatëse.
3. Plan Rilevimi i Pasurisë.
4. Relacioni sgarues

KRYETARI
Kristian SHKRELI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/ KRYETARI
Aleksandra Gjoni



Konceptoi: N. Baqli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE ASETIVE

RELACION

Mbi disa sqarime dhe dakordësime në lidhje me pasurinë nr 1/29, Zk nr 8598, objekt kërkese për regjistrim me VKM, paisje me çertifikatë pronësie, kartelet pasurie dhe fragment harte kadastrale, sipas gjendjes faktike në terren, dhe konform aktit të transferimit.

ASHK-së Drejtoria Vendore Shkodër

Nisur nga aplikimi i radhës për regjistrim, pasurie, bashkëlidhur dokumentacionit përkatës si dhe aplikimit të bërë në platformën e-Albania, po ju përcjellim këtë relacion, për të sqaruar situatën në lidhje me objektin e quajtur "Tregu" me nr pasurie 1/29, Zk nr 8598, ndodhur në qendër të qytetit Vau Dejës, që i përket nr rendor 342 të fletës inventarit. Me VKM nr 1423, datë 10.10.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vau Dejës të Qarkut Shkodrës", kjo pasuri është e transferuar "Në pronësi" të Bashkisë Vau Dejës me fushë përdorimi "Zhvillim ekonomik". Sipas inventarit të pronave të Bashkisë Vau Dejës, në fletën e inventarit kjo pasuri është e shënuar me nr 1/29, Zk 8598 me sipërfaqe të përgjithshme prej 800 m2 Truall, nga të cilat 663 m2 Ndërtesë.

Sipas plan rilevimit, tek "Shënime të veçanta" citoj: "Sip Truall= 800 m2, nga kjo Nd=663 m2, sipas formularit të inventarizimit të pronave i përket nr 1/29, ndërsa sipas hartës së ASHK DV Shkodër, korrespondon me nr 1/28 ; 1/29, dhe trualli përreth objektit është pjesë e pasurisë 1/56".

Sa më sipër, kërkojmë regjistrimin e pasurisë, paisjen me çertifikatë pronësie, kartelë pasurie dhe fragment harte kadastrale, në dakordësi dhe konform VKM-së nr 1423, datë 10.10.2008, bashkë me fletën e inventarit përkatëse, sipas Plan rilevimit dhe sipas Hartës së zyrës suaj.

Hartuesit e Relacionit

N. Baqli

E. Preka

M. Deda

KRYETARI

Kristian SHKRELI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETARI

Aleksandra Gjoni



5

VENDIM
Nr.1423, datë 10.10.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË VAU I DEJËS TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Vau i Dejës të qarkut të Shkodrës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 128 (njëqind e njëzet e tetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 924 (nëntëqind e njëzet e katër).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Vaut të Dejës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Vau i Dejës

Lidhja Nr. 1


Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-13	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
14-20	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
31-311,319	Infrastrukturë (troje të lira)	Në përdorim
34-30	Shërbim funeral	Në pronësi
21-23	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore	Në pronësi
325-330,335,338-340,342	Zhvillim ekonomik	Në pronësi
312-318,366-828,831-833,836-838	Infrastrukturë (rrugë vendore lulishte, trotuarë)	Në pronësi
553,903,909,911,918,923,924,896,	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproductive, kanale të treta)	Në pronësi
541-551,552	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim



PRONARI: BASHKIA VAU DEJES DATE 05.03.2026 QELLIMI: REGJISTRIM ME VKM

ADRESA: BASHKIA SHKODER DVASHK-SHKODER ZONA KADASTRALE 8598 NUMRI I PASURISE: 1/29
 QYTETI: VAU I DEJES INDEX HARTE L-D-5
 SIP. PASURISE -800m2 SIPERFAQE E GJURMES NDERTIMIT-663m2

KORNIZA REFERUESE GJEDDEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 500

Nr.	ORIENTIMI	PERDRIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI					
2	LINDJE					
3	JUG					
4	PERENDIM					


REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT
 EMRI: _____
 LICENCA: **Armand Velaj**
 NIPT: _____
 MESHKRI MIVULA: _____
 REALIZOI PER ASHK
 SPECIALISTI: _____
 DVASHKI: _____
 MESHKRI: _____
 KONFIRMIMI
 PERGJEGJESI/DREJTORI: _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: GPS, TERREN, ZYRE
 Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total, D-Matje Distancash;
PERCAKTIMI I KUFIRIT: P,H,K
 Kode per percaktimin e kufirit: P-Perfaqesues i Pronarve; K-Kufitaret te Gjithe; KP-Kufitaret Pjeserisht;
 PB-Perfaqesues Bashkie; HK-Harta Kadastrale;
SHENIME TE VECANTA:
ME KERKESEN E PRONARIT ESHTË REALIZUAR MATJA E PASURISE:
 Si p.truall -800m2 nga e cila nd.- 663m2. sipas formularit te inventarizimit te pronave i perket pasurja 1/29, ndersa sipas hartes se ASHK Shoder korrespondon me nr.1/28 ; 1/29 dhe truall perreth objektit eshte pjese e pasurise 1/56.

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARDHENJET ME KUFITARE

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PROJEKTARI: BASHKIA VAU DEJES **DATE 05.03.2026** **QELIMI: REGJISTRIM ME VKM**
ADRESA: BASHKIA VAU DEJES **ZONA KADASTRALE 8598** **NUMRI I PASURISE: 1/29**
QYTETI: VAU DEJES **INDEX HARTE L-D-5**
DIENAT E PASURISE **SIP. PASURISE -800m2** **SIPERFAQE E GJURMES NDERTIMIT-663m2**
LOJI I PASURISE TRUALL
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 500

No.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI					
2	LINDJE					
3	JUG					
4	PERENDIM					

<p>REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT</p> <p>EMRI: _____</p> <p>LICENCA: Armand Velaj</p> <p>NIPT: _____</p> <p>NENSIKRIMPVULA: _____</p> <p>REALIZOI PER ASHK</p> <p>SPECIALISTI: _____</p> <p>DIYASHK: _____</p> <p>JENSHKRIMI: _____</p> <p>KONFIRMIMI: _____</p> <p>PERGJEGJESI/DREJTORI: _____</p>	<p>TEKNOLOGJIA E MATJEVE: <u>GPS, TERREN, ZYRE</u></p> <p>Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total, D-Matje Distancash;</p> <p>PERCAKTIMI I KUFIRIT: <u>P, HK</u></p> <p>Kode per percaktimin e kufirit: P-Perfaqesues i Pronarve; K-Kufitaret te Gjithe; KP-Kufitaret Pjeserishi; PB-Perfaqesues Bashkie; HK-Harta Kadastrale;</p> <p>SHENIME TE VECANTA: ME KERKESEN E PRONARIT ESHTHE REALIZUAR MATJIA E PASURISE:</p> <p>Sip. truall -800m2 nga e cila nd. - 663m2, sipas formularit te inventarizimit te pronave i perket pasuria 1/29, ndersa sipas hartes se ASHK Shoder korrespondon me nr. 1/28 ; 1/29 dhe truallit perreth objektit eshte pjese e pasurise 1/56.</p> <p>PRONARI/BASHKIPRONARET-DEKLARIM MBI MARDHENJET ME KUPITARE</p>
---	---

FATURË PËR SHËRBIME KADASTRALE



Drejtoria Vendore/Zyra: Z.V.R.P.P. SHKODËR

NIPT: K67204022R

Data e lëshimit të faturës: 18/03/2026

Nr. fature: 6316

Adresa: LAÇ (VAU-DEJES)

Pagesa për shërbimet Kadastrale

Klienti: BASHKIA VAU - DEJES BASHKIA VAU - DEJES

Nr. i kërkesës për shërbime: 6400 datë: 18/03/2026

ID/NUIS: K567050070

Pagesat për tatim/taksë kalim të drejtë

Klienti: BASHKIA VAU - DEJES BASHKIA VAU - DEJES

Nr. i kërkesës për shërbime: 6400 datë: 18/03/2026

ID/NUIS: K567050070

№	Përshkrimi i shërbimit	Kodi i logaritit ekonomik	Perfituesi	Banka/IBAN	Vlera (lekë)
1	Shërbime (...)	7112300	Z.V.R.P.P. SHKODËR	Credins- AL3721211009000000001216844	11000
2	Gjobë për vonesë (...)	7115416	Z.V.R.P.P. SHKODËR	Credins- AL37212110090000000001216844	0

№	Emërtimi i të ardhurës	Kodi i logaritit ekonomik	Perfituesi	Thesat/Banka	Vlera (lekë)
3	Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë 97%	-	-	-	0
4	Taksa kalimit të së drejtës së pronësisë 3%	-	-	-	0

№	Emërtimi i të ardhurës	Kodi i logaritit ekonomik	Perfituesi	Banka/IBAN	Vlera (lekë)
5	Tatim për kalimin e të drejtës së pronësisë	-	-	-	0

PAGESA PËR ASHK	Të ardhura për ASHK (1+2+4)	11000
	Tatim i kalimit të së drejtës së pronësisë (5)	0

PAGESA PËR BASHKINË taksë kalim të drejtë pronësie (3)	0
---	---

PAGESA TOTALE PËR APLIKIMIN (1+2+3+4+5)	11000
--	-------

Pagesa duhet të kryhet nga subjekti brenda 30 ditëve kalendarike nga momenti i përcjelljes në mënyrë elektronike nga ASHK.
 Pagesa mund të kryhet edhe pranë Postës Shqiptare.
 Kjo faturë është miratuar me Udhëzimin nr.125, datë 06.10.2025 nga Ministria e Financave.



1. Tërfaqet e shërbimeve kadastrale janë të miratuara me VKM nr.389, datë 13.05.2020, i ndryshuar.
 2. Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë llogaritet në bazë të ligjit nr.9632, datë 30.10.2016 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.
 3. Tatimi i kalimit të së drejtës së pronësisë llogaritet në bazë të ligjit nr.29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", Udhëzimit nr.34, datë 29.12.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat nga uejtërimi i pasurive të paluajtshme".

PROJEKT

Digitally signed by Marjola Marku
Date: 24.03.2026 13:30:53 CET
Reason: Regjistruar
Location: Shqipëri

Digitally signed by Elsa Tenushi
Date: 24.03.2026 13:38:41 CET
Reason: Nëpunës zbulues
Location: Shqipëri

Digitally signed by Aleksandra Gjoni
Date: 24.03.2026 14:00:56 CET
Reason: Nëpunës autorizues
Location: Shqipëri

Digitally signed by Alfred Papa
Date: 24.03.2026 15:31:04 CET
Reason: Nëpunës thesari
Location: Shqipëri

SEKRETARAT
BASHKIA E VAN DEJES

Institucioni
NIPT - I
Kod Institucioni
Entiteti i Qeverisjes
Distrikti (TDO)

Bashkia Van Dejes
K 567050070
2157001
157
3333

Nr. i Kuponit

URDHER - SHPENZIMI

NR. 205

24.03.2026

Nr. i Punonjseve

Nr.	Struktura e llogarive						SHUMA ne Leke	Objekti i shpenzimit
	Gr.	Kap.	Kod Program	Llogaria Ekonomike	Nen Llogaria	Kod Projekti		
1	00	01	01110	602	6022099	9999999	11,000.00	Sherblime te tjera Tarifa sherblimi
TOTALI ME SHIFRA							11,000.00	X

TOTALI ME FJALE

Njëmbëdhjetë mijë

IBAN AL56 2121 1016 0000 0000 0121 6844

Te dhena per kreditorin perfitusës :

Emri i perfituesit	
Drejtoria Vendore e ASHK-se Shkoder	
NIPT - I	K67204022R
Neshteg.bank	AL56 2121 1016 0000 0000 0121 6844
Emri Bankes	Banka Credins
Adresa e Bankes	

Dokumentat ngjitur Urdher Shpenzimit :

Emertimi	Nr. Dokumenti	Date Dokumenti
Cek		
Xhirim		
Nr i Urdherit te blerjes		
Te tjera	1.Urdher Kryetari nr 180	19.03.2026
(Emertime, numer date)	2.Fature per arketim nr 6316	18.03.2026

Shenim: Qelizat per "Nr. i kuponit" plotesohet nga nepunesi i Thesarit/Institucionit buxhetor